# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-474044**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Nuk ka asnjë firmë që më implikon”/ Blushi i përgjigjet Ramës: Po bonusi për “Integrated Energy BV” dh e kontrata e inceneratorit të Elbasanit? “Shporrja” është zgjidhja |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/nuk-ka-asnje-firme-qe-me-implikon-blushi-i-pergjigjet-rames-po-bonusi-per-integrated-energy-bv-dhe-kontrata-e-inceneratorit-te-elbasanit-shporrja/1029714/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 14:33:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 14:33:09 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `17868313dc8a51527f41e0d8af9411f55568ab2ef669a362757763bf2cf360b0` |
| TEKSTI | `fbbc95b84cc21d8cb945353a33028c6906908c10ba8310a598d0ffa08ba16397` |
| PAMJA | `26288a3b0e9d8d86239f1b0bd8127e94a7477ea0f2aae9685f12c88dbe4b225d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `455676ab58e9c980d3e6c080dc38b4683baf33b899ff781b8c8c7bd7d3d47bf3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3dbf5264f26ae921c8f8735760cb378b1b626a14b73f487ffe641eb8f02fca55` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/455676ab58e9c980d3e6c080dc38b4683baf33b899ff781b8c8c7bd7d3d47bf3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Nuk ka asnjë firmë që më implikon”/ Blushi i përgjigjet Ramës: Po bonusi për “Integrated Energy BV” dhe kontrata e inceneratorit të Elbasanit? “Shporrja” është zgjidhja



Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë, Tedi Blushi, ka reaguar ndaj video-mesazhit të kryeministrit Edi Rama, në të cilin ky i fundit deklaroi se nuk ka asnjë vendim apo firmë që e lidh me shkeljen e ligjit.

Blushi kundërshton këtë qëndrim duke sjellë në vëmendje dy raste që, sipas tij, dëshmojnë të kundërtën: bonusin e dhënë për kompaninë “Integrated Energy BV” dhe procedurën e koncesionit për inceneratorin e Elbasanit.

Në reagimin e tij, ai e akuzon kryeministrin për papërgjegjshmëri dhe arrogancë, duke e cilësuar drejtues të një organizate kriminale që, sipas tij, ka marrë nën kontroll të gjithë shtetin.

Sipas pretendimit të Blushit, më 7 dhjetor 2016, Edi Rama firmosi dhënien e një bonusi prej 8% të pikëve për kompaninë “Integrated Energy BV sh.p.k.”, në kuadër të procedurës konkurruese për ndërtimin e inceneratorit të Tiranës.

Blushi thekson se kjo kompani nuk ekzistonte në momentin kur u firmos bonusi, duke pretenduar se vendimi e favorizoi atë në garën për inceneratorin.

“Edi Rama, në kundërshtim me çdo ligj në fuqi, më 7.12.2016 firmosi dhënien e bonusit prej 8% të pikëve kompanisë Integrated Energy BV sh.p.k. për procedurën konkurruese për ndërtimin e inceneratorit të Tiranës. Por, në fakt, kjo kompani nuk ekzistonte në momentin kur Kryeministri firmosi bonusin që e favorizonte atë në procedurën konkurruese”, shprehet ai.

Rasti i dytë i përmendur nga sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë lidhet me inceneratorin e Elbasanit. Ai pretendon se kryeministri ka miratuar negocimin pa shpallje të kontratës koncesionare për ndërtimin e

të fundit/


Asllani shkëlqen ndaj Bjellorusisë, pas tij renditen Hysaj e…


Maqedonia e Veriut regjistroi 741,446 vizitorë gjatë shtatë…


Atdhe Nuhiu, figura që bashkon futbollin e Kosovës me atë të…


Ymeri: Deklaratat e PDK-së dhe VV-së për Hagën pritet të votoh…


Rama kritikon SPAK dhe GJKKO pas publikimit të…


Rama u përgjigjet kritikëve: Kundërshtarët e mi janë të përdalët …


Risteski: Karta digjitale do t'i japë fund pritjeve të studentëve në…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

pretendon se kryeministri ka miratuar negocimin pa shpallje të kontratës koncesionare për ndërtimin e inceneratorit, ndonëse institucionet përgjegjëse ishin informuar se procedura nuk ishte e ligjshme.

Blushi deklaron se Edi Rama ka vepruar në kundërshtim me ligjin "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik/Privat", duke firmosur procedurën e negocimit pa shpallje për kontratën koncesionare të inceneratorit të Elbasanit.

Ai shton se Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Ëngjëll Agaçi, ishte njoftuar zyrtarisht nga Drejtori i Agjencisë së Prokurimeve Publike, z. Eduard Ahmeti, se mënyra e përzgjedhur për dhënien e koncesionit ishte e paligjshme.

Në mbyllje të reagimit, Blushi thotë se nuk duhet pritur dorëheqja e kryeministrit dhe as largimi i tij vullnetar nga pushteti. Ai e shoqëron deklaratën me akuza të rënda dhe bën thirrje për largimin e Ramës.

"Edi Rama vërtetoi sot jo vetëm kartelën e tij klinike, por edhe papërgjegjshmërinë e një kleptomani dhe arrogancën e një banditi, që drejton me gjakftohtësi organizatën kriminale, që ka marrë peng të gjithë shtetin", shkruan Blushi.

"Ky mashtrues i pacipë, që sfidoi sot këdo duke pretenduar se nuk ekziston asnjë vendim apo firmë e tij në shkelje të ligjit, ja ku i ka dy gjurmë, që ulërasin në dritën e diellit", vijon ai.

"Askush të mos lodhet duke pritur dorëheqjen e tij dhe as të mos ngjiret me kërkesën për largimin e vullnetshëm të tij nga pushteti.

Asnjë hajdut nuk vjedh për t'ia dorëzuar më pas plaçkën policisë.

Asnjë bandit nuk vetëndalet me ndërgjegje në kriminalitetin e vet.

Shporrja, dhe vetëm shporrja, është e vetmja zgjidhje që duhet ta marrin në dorë shqiptarët!

Ky është i vetmi ilaç për shpëtimin e Republikës, të marrë peng nga një i sëmurë mendor, kleptoman dhe mafioz i pandreqshëm!", përfundon reagimi i Tedi Blushit.

Shtuar më 27.09.2026 16:33

Tags: -Politikë , kryesorë , Lajmet e fundit , Shqiperia , Të Gjitha


Rama kritikon SPAK dhe GJKKO pas publikimit të mesazheve të Vlora…


Rama u përgjigjet kritikëve: Kundërshtarët e mi janë të përdalët e rrugëve…


Këlliçi akuzon Ramën për mungesë përgjegjësie në skandalin e SHISH:…


Reforma në Drejtësi/ Rama: Pa mua dhe PS, SHBA e BE do bënin Noc…


Parashikohet vjeshtë më e ngrohtë se normalja, zbuloni surprizat e motit


Klos/ Pensionistët protestë kundër Reformës Territoriale



Ishin në kërkim nga autoritetet italiane dhe kosovare, arrestohen dy…


Italia rrezikon Europianin, presidenti Çeferin lëshon alarmin: UEFA pret që…

albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!


Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.